

## Letër familjes

I dashur nxënës, të dashur familjarë,

Në Kapitullin 5 do të fillojmë të trajtojmë marrëdhëniet vijore – ku modifikimi i një ndryshoreje çon në një modifikim të caktuar të një ndryshoreje tjetër. Në klasë do të përshkruajmë situata, do të ndërtojmë tabela të dhënash në lidhje me këto situata, dhe do të formulojmë ekuacione vijore që i përshkruajnë këto marrëdhënie. Ja një shembull i një lloj problemi me të cilin do të merremi. Përpiquni të zgjidhni ndonjë pjesë të problemit, para se ta fillojmë kapitullin.

Tri kompani telefonash kanë tarifa interurbane:

Kompania	Tarifa
Easy Access Company	\$1,00 për minutën e parë; pastaj 25 cent për minutë
Call Home	20 cent për minutë
Metro Communication	\$3,00 për minutën e parë; pastaj 15 cent për minutë

Ja disa çështje që do të marrim në shqyrtim:

- Për secilën kompani, llogaritni sa duhet paguar për telefonata që zgjatin 5 minuta, 15 minuta dhe për dy kohëzgjatje të tjera. Paraqitini rezultatet në një tabelë.
- A ka ndonjë kompani që është gjithmonë më e lirë se të tjerat? Nëse ka, cila? Nëse jo, tregoni se në ç'raste do të përdorni këtë ose atë kompani, si më të lirën.

Gjithashtu do të mësojmë të parashikojmë, duke parë tabelat ose rregullat algjebrike, se cilave ekuacione u përgjigjen grafikë në trajtë vijash të drejta. Pastaj, të nisur nga një grafik ose një tabelë, do të përcaktojmë pjerrësinë dhe pikëprerjen në boshtin y (konstanten e ordinatës).

**Fjalori** Terma të rinj që do të mësojmë gjatë këtij kapitulli:

<b>koeficient</b>	<b>tarifë</b>	<b>ndryshore</b>
<b>konstante</b>	<b>pjerrësi</b>	<b>shpejtësi</b>
<b>marrëdhënie vijore</b>	<b>shpejtësi</b>	<b>pikëprerje në y</b>
<b>përpjesëtimore</b>		

### Çfarë mund të bëni në shtëpi?

Gjatë javëve të ardhshme, nxënësi mund të tregojë interes për marrëdhëniet vijore ose për mënyrat e ndryshme se si ekuacionet vijore shprehen në botën jashtëshkolllore. Së bashku, mund të zbatimeni duke përdorur ekuacione vijore për të llogaritur pagesa për punë, duke përdorur tarifa të ndryshme orare.